



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr. 20, datë 23.10.2019

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË ZBATIMIT TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME**  
**VENDORE NË FUQI, PAS MIRATIMIT TË HARTËS SË PËRDITËSUAR TË**  
**KUFIJVE ADMINISTRATIVO-TERRITORIALË PËR NJËSITË E**  
**VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 360, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**


1. Zbatimi i përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor në fuqi, do të realizohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore që e ka këtë territor në administrim, sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë.
2. Për territoret e shtuara në administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë, administrimi i territorit nëpërmjet përcaktimeve të Planeve të Përgjithshme Vendore, do të realizohet duke u bazuar në përcaktimet e PPV-së në fuqi të bashkisë kufitare.
3. Për territoret e shtuara në administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë, të cilat nuk rezultojnë të planifikuara nga PPV-të në fuqi të bashkive kufitare, administrimi i territorit do të realizohet duke u bazuar në përcaktimet e Vendimit Nr. 1, të KKT-së, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar.



4. Përcaktimet e pikës 2 të këtij vendimi, gjejnë zbatim deri në rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë që ka përfutur territorin e shtuar në administrim të saj.
5. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT-në dhe AZHT-në, gjatë procesit të zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, sipas përcaktimeve të këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**



**EDIRAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

